

UDHËZIM

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 3165, DATË 12.5.2004, “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË PËRKTHYESVE TË JASHTËM, TARIFAT E SHPËRBLIMIT TË PËRKTHYESVE TË JASHTËM DHE TARIFAT E PËRKTHIMIT ZYRTAR QË DUHET TË PAGUAJNË TË TRETËT”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” (i ndryshuar), Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr.3165, datë 12.5.2004 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm, tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime.

1. Pika 1 ndryshon si vijon:

“Ministri i Drejtësisë, brenda datës 15 dhjetor të çdo viti, miraton listën vjetore të përkthyesve të jashtëm të Ministrisë së Drejtësisë me të paktën tre përkthyes për çdo gjuhë komunikimi të përcaktuar në konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë”.

2. Në pikën 2, paragrafi i dytë shfuqizohet.

3. Në pikën 6, shtohet paragrafi si vijon:

“Pedagogët dhe punonjësit shkencorë të barasvlefshëm me ta me një përvojë mbi 5 vjet në mësimdhënien e gjuhës në nivel universitar apo në fushën e përkthimit zyrtar që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 9 të udhëzimit, kontraktohen pas përfundimit të fazës së parë të vlerësimit të të dhënave profesionale. Në rast se numri i nevojshëm i përkthyesve të jashtëm plotësohet përmes kësaj procedure, testimi me shkrim në atë gjuhë anulohet”.

4. Pika 8 ndryshon si vijon:

“Ministri i Drejtësisë, për nevoja emergjente, urdhëron kontraktimin e përkthyesve të njohur në qarqet përkatëse ose të një agjencie që ofron këtë shërbim në rastet kur:

- a) lind nevoja për përkthim në gjuhë të papërfshira në listën vjetore;
- b) numri i kandidatëve të paraqitur për konkurrim është më i vogël se tre;
- c) niveli i kandidatëve të paraqitur në konkurrim është i ulët;
- d) përkthyesit e kontraktuar nuk arrijnë të përmbushin detyrimet kontraktuale.

Numri i përkthyesve të kontraktuar me këtë procedurë nuk duhet të kalojë 1/3 e numrit të përkthyesve të kontraktuar me konkurs.”

5. Pas pikës 8 shtohet pika 8/1 me këtë përmbajtje:

“Shpenzimet e përkthimit që kryhen për institucionet e tjera përballohen nga fondet e këtyre të fundit dhe si përkthyes do të zgjidhen vetëm ata persona që janë përzgjedhur nga Ministria e Drejtësisë sipas këtij udhëzimi”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Fatmir Xhafaj

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Malaj